"HYSENBELLIU GROUP" SHPK
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT L51610033Q

VENDIM

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Sot më datë 17.07.2020, ora 09:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k të ndodhur në Rruga "Panorama", Kulla e Biznesit, Njësia Bashkiake Nr. 9 Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k, një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar më 10/04/2015, me NUIS L51610033Q.

Në mbledhje është i pranishëm ortaku:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të Shoqërisë

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm ortakë që përfaqësojnë shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2019;
2. Dhënien e miratimit për kalimin e fitimit në vlerën në vlerën 3,067,158 (tremiljon e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) Lek, në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital;
3. Autorizimin e administratores, Znj.Folitjona Puravelli, që personalisht apo nëpërmjet personave të autorizuar, të depozitojë këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për efekt të regjistrimit të tij në bazë të nenit 43 të ligjit 9723 datë 03.05.2008 për "QKB".

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar).

"HYSENBELLIU GROUP" SHPK
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT L51610033Q

Për sa më sipër:

ASAMBLEJA E SHOQËRISË

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar z. Agim Qenani lindur në Korçë, e banues në Elbasan, pajisur me Liçensë Nr.53, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Hysenbelliu Group" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2019;
2. Të miratojë kalimin e fitimit në vlerën 3,067,158 (tremiljon e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) Lek, në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2019;
3. Të autorizojë administratoren e shoqërisë, znj. Folitjona Puravelli, të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi të autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për efekt të regjistrimit të tij.

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 09:30.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Z.IRFAN HYSENBELLIU

HYSENBELLIU GROUP
NIPT: L51610033Q